

eppc kërkon një Drejtor Shitjesh për klientin e saj i cili është një biznes i konsoliduar dhe me një pozicion të qëndrueshëm në tregun Shqiptar. Biznesi ushtron prej më shumë se 15 vitesh aktivitetin në fushën e tregtisë me shumicë të artikujve ushqimore duke përfaqësuar 104 marka të ndryshme për të cilat gëzon ekskluzivitetin e tregtimit në Shqipëri dhe në Ballkan.

Ky pozicion ka të bëjë me planifikimin, drejtimin, organizimin dhe kontrollin e aktiviteteve të shitjes për territorin Shqiptar. Aspekte të rëndësishme të punës janë dhe studimi i tregut, analiza e çmimeve të produkteve, menaxhimi i shitësve në terren, hartimi dhe ndjekja e objektivave të shitësve, organizimi i zonave të shitjes, bashkëpunimi me njësitë e tjera të kompanisë, etj.

### KËRKESAT PËR KËTË POZICION JANË:

- Arsimi i lartë. Preferohen drejtime si Menaxhim, Marketing dhe Ekonomik.
- Diploma të niveleve master ose specializime të ndryshme përbëjnë avantazh.
- Zotërimi i gjuhës Angleze dhe Italiane është avantazh.
- Eksperienca e punës në drejtimin e shitjeve dhe menaxhim stafi është domosdoshmëri.
- Përdorimi i MS Office.
- Person energjik dhe me aftësi komunikuese shumë të mira.
- Aftësi në drejtim, organizim dhe shitje.
- Aftësi prezantuese dhe negocimi.

### Të dhënat

<b>Pozicioni:</b>	Drejtor i Shitjeve
<b>Vendndodhja:</b>	Tiranë
<b>Raporton tek:</b>	Drejtori i Përgjithshëm
<b>Vartës direkt:</b>	Po
<b>Udhëtime pune:</b>	Kryesisht në Shqipëri.
<b>Orari:</b>	40 orë pune në javë
<b>Pagesa:</b>	Pagë bazë + bonus në varësi të performancës
<b>Përfitime të tjera:</b>	Makinë pune ose kuotë për mbulimin e shpenzimeve të transportit
<b>Kontrata:</b>	Sipas Kodit të Punës
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	15.07.2011

### Si të aplikoni

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke përmendur pozicionin për të cilin aplikoni tek:

[info@eppc.al](mailto:info@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.